



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 590/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi -Kryetar z. Blerim Dina–Referues z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: **I.PN.EU” SH.P.K & ”BEREQETI-ING” SH.P.K** – Prishtinë, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: **“N.N.P Ndertimtari”** - Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të Komunës së Prishtinës”** me nr.prok:616-19-1903-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën: 08.10.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: **I.PN.EU”SH.P.K&”BEREQETI-ING” SH.P.K** – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të Komunës së Prishtinës”** me nr.prok: 616-19-1903-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

II.ANULOGHET, Vendimi i AK-së Njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të Komunës së Prishtinës”** me nr.prok: 616-19-1903-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K – Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, të njëjtit i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 05.04.2019

Data e fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 06.05.2019

Data e vendimit se AK, për dhënie të kontratës është bërë me dt: 02.09.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 06.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 04.09.2019

Data e vendimit të AK –së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 28.08.2019.

Operatori ekonomik ankues: I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me datën: 12.09.2019 me nr. 590/19, kundër vendimit të autoritetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr.prok: 616-19-1903-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.2, 52, 56, 58, 59, 60, 61 të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 16.09.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese profesionale e prokurimit në raportin e dt: 27.09.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K – Prishtinë, në finalizim

teanalizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

OE ankues: "I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K" pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja thekson se qëllimi i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve, andaj trajtimi i OE ankues si i eliminuar nuk është diskriminues, sepse me rastin e kërkesës për sqarime lidhur disa çmime që AK-së i ka konsideruar si çmime jo normalisht të ulëta. OE ankues nuk ka ofruar përgjigjeje bindëse se si do ta realizoj kontratën, por është transparente dhe në harmoni me nenin 7 të LPP-së. Duke u bazuar në këto fakte ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar, sepse AK-së duke kërkuar sqarim i ka dhënë mundësin OE ankues që të jap shpjegime se si do ta realizoj kontratën, shpjegimi –përgjigja e OE ankues nuk ishte bindëse sepse nuk ishte në harmoni me arsyet e cekura në nenin 61 të LPP-së dhe nuk ishte në harmoni me nenin 4 të Rregullores për çmime jo-normalisht të ulëta, që janë të parapara si përgjigjeje të pranueshme, dhe në atë mënyrë të gjithë OE i ka trajtuar në mënyrë të barabartë. Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar. OE ankues "I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K" pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 52 pika 6 dhe nenin 56, neni 58 pika 3, dhe neni 59 pika 2 dhe pika 5 të LPP-së, sipas OE ankues. Pretendimi se është shkelur paragrafi 6 i nenit 52 nuk qëndron sepse në DT dhe në nuk ishte kriteri që kontrata do i epet ofertuesit të përgjegjshëm me çmimin me të lirë të poentuar, dhe një kriter i tillë nuk është i ndaluar. Pretendimi se është shkelur neni 56 nuk qëndron sepse oferta e OE ankues nuk është eliminuar për shkak të kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, por i njëjti është eliminuar për shkak të disa çmimeve jo normalisht të ulëta. Pretendimi se është shkelur neni 58 pika 3, nuk qëndron sepse procesverbali i hapjes është në platformën elektronike në E-prokurim i ngarkuar, dhe në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë kërkesë që ju ka drejtuar OE ankues AK-së lidhur me procesverbalin e hapjes, Andaj edhe pretendimi është i pa bazuar. OE ankues pretendon se është shkelur neni 59 pika 2 dhe 5 i LPP-së. Ekspertja thekson se qëllimi i këtij pretendimi është komunikimi për të siguruar informata shtesë dhe kufizimet në mes AK-së dhe OE në komunikim. Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar sepse komunikimi ishte me shkrim konform LPP. OE ankues: "I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K" pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 60 pika 1.1 të LPP-së, sipas OE ankues.

Qëllimi i këtij neni është të përcaktohet kriteri për dhënie të kontratës siç parashihet:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Ekspertja konstaton se kriteri për dhënie të kontratës në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit ishte "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të poentuar" dhe nga ofertat e përgjegjshme OE i shpërblyer me kontratë ishte me çmim me të lirë të poentuar

nga tenderuesit e përgjegjshëm. Andaj,Ekspertja Konstaton se ky pretendim është i pa bazuar. OE ankues: "I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K" pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së,sipas OE ankues .

Ekspertja sqaron se neni 61 i LPP-së ndër të tjera përcakton :

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalishti ulët, autoriteti kontraktues dot të dërgojë një kërkesë meshkrimi të tenderuesit ku kërkohej nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: një ndarjet e elementeve për bërë set të tenderit dhe shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafit 2. të këtij neni.
2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalishti ulët, autoriteti kontraktues dot të marrë parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me ekonominë e procesit të prodhimit të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit çfarëdo zgjidhjeteknike që janë ofruar ose zgjedhur çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimit të aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.
3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrë njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.
4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalishti ulët, autoriteti kontraktues dot të refuzojë tenderin.
5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen.
6. KRPP-ja nxjerr akt nënligjor për rregullimin në hollësi për përcaktimin e çmimit jo-normalisht të ulët. Ekspertja thekson se konform neni 61 par 1, AK-së ka kërkuar informata lidhur me disa çmime që i ka konsideruar të ulëta, Përgjigjja e OE. ankues nuk ishte në harmoni me pikën 2.1, 2.2, 2.3 të këtij neni dhe AK-së pas marrjes parasysh të shpjegimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas këtij neni AK-së vendos se tenderi është jo normalisht i ulët. Në nenin 61 paragrafin 6 parashihet edhe, Rregullorja për Tenderët Jo – Normalisht të ulët (B57)

Ekspertja sqaron se për të eliminuar një tenderues për çmime jo-normalisht të ulëta duhet të plotësohen tri kushte :

- Të dorëzohen te paktën 3(tre) tenderë
- Çmimi i ofruar është me shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm .
- Çmimi i ofruar është me shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Ekspertja thekson se AK-së me rastin e vlerësimit nuk e ka bërë kalkulimin për ta sqaruar se a janë plotësuar këto tri kushte që parashihen edhe në mënyrë tabelore për ta eliminuar një ofertues mbi bazën e çmimeve jo-normalisht të ulëta, edhe pse nga tabela e çmimeve sipas poentimit shihet çarte se këto tri kushte janë plotësuar për ta shpallur si tenderues me çmim jo-normalisht të ulët Ofertuesin ankues .(Sqaroj se edhe sikur të bëhet kalkulimi nga AK-së rezultati do të ishte i njëjte sepse çmimet janë jo të përafërta por për shkak të korrektësisë dhe etikës profesionale dhe me qellim që në raste tjera të bëhet kalkulimi konform shembullit të dhënë në Rregulloren B57 nga AK-së)

AK-së siç parashihet me rregullore e ka informuar KRPP. për eliminimin mbi bazën e çmimeve jo normalisht të ulëta Andaj ,Ekspertja Konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendura të operatorit ekonomik,ta Apropojë-si PJESËRISHT TË BAZUARË (për arsyen që u cekën te përgjigjet në secilin pretendim),dhe i rekomandon panelit shqyrtues që ta lë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës 30.09.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.09.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.10.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE ankues, përfaqësuesit e AK-së, si dhe ekspertja shqyrtuese, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Mushica deklaroj: me vendimin e 19.06.2019 Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues kompaninë e cila me çmim te poentimit ka qenë me te larte dhe me procesverbal te hapjes me e ulet, për te cilën nuk kemi bërë ankese, kriteri ka qenë te jete me i lire ndërsa ne DT ka qenë me Poentim, ne nuk jemi informua ne mënyrë elektronike nga Autoriteti

Kontraktues dëshminë që na kanë përcjell neve për procesverbal të hapjes dhe për këtë kemi dëshmitë e-mail adresën që kemi kërkuar, me datën 19.06.2019 në ora 10:32 kemi dëshmitë edhe të e-prokurimit ku vazhdimisht informohemi kopja e uebfaqes për mos informim. Në sqarime kemi qenë dhe llogaritjeve që kemi bërë neve nuk na del i ulët, pozicioni i rrethojave është 40 euro dhe është pozicioni kryesor, dhe nuk kanë qenë të gjitha pozicionet jo-normalisht të ulëta.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi deklaroj: Sipas komisionit vlerësues gjatë sqarimit të tenderit OE ankues nuk kanë mundur të argumentojnë në sqarime dhe ka dhënë vetëm deklarata dhe sipas komisionit vlerësues kompania nuk ka mundur të arsyetojë çmimet.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Krasniqi deklaroj: Ofertat që kanë qenë shihet që të 3 kompanitë kanë qenë me të ulëta. AK nuk e ka përdorur rregulloren shihet që janë çmime shumë të ulëta. Unë mbështet raportin të dhënë në ekspertizë. OE ankues ka ofertuar me çmim të poentuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Mushica deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovoj ankesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhë poshtë ankesën e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Duke pas për bazë kriterin çmimi më i ulët i poentuar Autoritetit Kontraktues i lejohet që varësisht prej rëndësisë që kanë artikujt të mund të poentojë në mënyrë që të vijë deri të çmimi më i arsyeshëm, pasi që vlerësimi i ofertave në këtë rast bëhet në bazë të poenave që i është dhënë secilit pozicion dhe për kontratë rekomandohet OE i cili ofron çmim më të ulët të poentuar, ndërsa kontrata nënshkruhet dhe realizohet sipas çmimeve të ofruara sepse tek ky kriter nuk lejohet që të përcaktohen piket duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm dhe se funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët.

Duke pas për bazë këtë Paneli shqyrtues vlerëson që kriteri i çmimit më të ulët me poentim , ka për qëllim shmangien e manipulimit me çmimeve përmes pozicioneve të ndryshme nga ofertuesit.

Poentimi çmimeve minimizon mundësitë e manipulimit me çmime pasi që çmimet poentohen në bazë të përqindjes së dhenë për secilin artikull apo për grup artikujsh.

Pra tek kriteri çmimi më i ulët me poentim Autoritetet Kontraktuese duhet eliminuar praktikën kur çmimet e njërit ofertues i krahason me çmimet e ofertuesve tjerë pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar me çmimet me ofertuesit tjerë, sepse në rastet kur kemi krahasimin e çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjënjë zbatim Rregulla për Tenderët Abnormalisht të ulët, apo kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësisht nga piket maksimale përcaktohet fituesi, pra tek kriteri tenderi me çmimi më të ulët i poentuar për kontratë rekomandohet OE i cili ofron çmim më të ulët të poentuar pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK– Kuvendi i Komunës së Prishtinës,
- 1x1 OE- I.PN.EU"SH.P.K&"BEREQETI-ING" SH.P.K – Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.